



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 1131 prot.

Tiranë më 30.6.2021

Lënda: Mendim mbi projektvendimin

MINISTRISË SË BRENDSHME

Tiranë

Në përgjigje të shkresës suaj nr.1886/3 prot., datë 25.06.2021, me anë të së cilës kërkohet mendim mbi projektvendimin “Për miratimin në parim të Marrëveshjes për Bashkëpunimin Policor ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Moldavisë”, Zyra e Komisionerit vlerëson të nevojshme të realizohen disa ndërhyrje konform parashikimeve të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Në këtë kuadër sugjerojmë që, pas pikës 3, të nenit 5, të përfshihen parimet ligjore në pikat si më poshtë:

4. “Pala Kontraktuese që ka transmetuar të dhënat, duhet të sigurojë, që këto të dhëna të jenë të sakta dhe kur është e nevojshme të përditësuara dhe që përmbajtja e tyre t’i shërbejë qëllimit të kërkuar. Nëse konstatohet, që janë transmetuar të dhëna të pasakta ose të dhëna që nuk duhet të ishin transmetuar, atëherë pa humbur kohë duhet njoftuar pala marrëse. Palët kontraktuese duhet të ndërmarrin çdo hap të arsyeshëm për të fshirë apo korigjuar të dhëna të pasakta në lidhje me qëllimin për të cilin janë përpunuar”;
5. “Të dhënat personale të transmetuara duhet të ruhen për aq kohë, por, jo më tepër sa është e nevojshme për qëllimin për të cilin janë transmetuar.”

Gjithashtu, pas pikës 2, të nenit 11, të shtohet një pikë me këtë përmbajtje: “Palët Kontraktuese të cilat shkëmbejnë këto të dhëna janë të detyruara, që të dhënat personale të cilat janë transmetuar, të mbrohen nga akseset e paautorizuara, ndryshimet dhe publikimi i paautorizuar.”

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

